

LIGJ  
Nr. 43/2020

PËR AKTIVITETET E TURIZMIT DETAR  
(Ndryshuar me ligjin nr. 105/2024, datë 19.9.2024)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

**Objekti**

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave, kushteve dhe kriterëve për aktivitetet e turizmit detar, i mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtim, infrastrukturës së nevojshme për ushtrimin e tyre dhe përcaktimi i përgjegjësiwe institucionale për këtë fushë në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

**Fusha e zbatimit**

Dispozitat e këtij ligji zbatohen për:

- aktivitetet e turizmit detar që zhvillohen përgjatë vijës bregdetare, hapësirës detare dhe në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë nga persona fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj;
- individë, vendas apo të huaj, të cilët kryejnë lundrime për qëllime turistike dhe argëtim me mjetet e tyre lundruese ose të marra me qira në hapësirën detare dhe në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë;
- mjetet lundruese vendase dhe të huaja, të cilat kërkojnë të hyjnë, të qëndrojnë, të lundrojnë dhe/apo të përdorin hapësirën detare shqiptare për qëllime private apo tregtare në fushën e aktivitetëve të turizmit detar.

Neni 3

**Përkufizime**

(Ndryshuar pika 14 me ligjin nr. 105/2024, datë 19.9.2024)

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Aktivitete të turizmit detar” janë veprimtaritë që ushtrohen në vijën bregdetare, hapësirën detare dhe në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë, të tilla si lundrimi për qëllime turistike dhe argëtim, *surf*-i, zhytja çlodhëse, *windsurf*-i, ski në ujë, *wakeboard*-i, motor uji, peshkimi turistik etj.

2. “Bovë” është enë pluskuese, që vihet në det si shenjë ose për të lidhur atje, përkohësisht, mjete lundruese.

3. “Certifikatë klasifikimi dhe lundrimi të sigurt” është dokument i lëshuar nga shoqëria klasifikuese për të kryer një ose disa veprimtari të caktuara në fushën e detarisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. “Jaht” është mjet lundrues vetëlëvizës, me motor ose vela, i cili mund të ketë më shumë se një kallumë, i destinuar dhe i pajisur për qëndrim të gjatë në det, për qëllime turistike dhe argëtim, që përdoret për nevoja personale apo qëllime tregtare.

5. “Hapësira detare” përfshin detin e brendshëm dhe detin territorial, sipas përcaktimeve të Konventës së OKB-së mbi të drejtën e Detit, 1982, ratifikuar me ligjin nr. 9055, datë 24.4.2003, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën mbi të drejtën e detit”, të OKB-së”.

6. “Kroçerë”, në kuptim të këtij ligji, është anije për pasagjerë, e cila transporton persona për qëllime turistike në vende të ndryshme brenda hapësirës detare dhe ujërave të brendshme të Republikës së Shqipërisë ose ato ndërkombëtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

7. “*Kitesurfing*” është aktiviteti, në të cilin përdoret një dërrasë lundruese, që shfrytëzon fuqinë e erës me një balonë të madhe e të kontrollueshme dhe që lëviz nëpër ujë.

8. “Kontrata e çartërimit “*Bareboat*” për mjetin lundrues për argëtim”, në kuptim të këtij ligji është kontrata, sipas së cilës njëra nga palët merr përsipër t’i dorëzojë palës tjetër mjetin lundrues për një periudhë të caktuar kohe, kundrejt pagesës së një tarife, pa ekuipazh.

9. “Kontrata “Çarter me kohë” e mjetit lundrues për zbavitje”, në kuptim të këtij ligji është kontrata, me të cilën njëra palë merr përsipër të vërë në dispozicion të palës tjetër mjetin lundrues për një periudhë të caktuar kohore, kundrejt një pagese të caktuar, përfshirë kapitenin dhe ekuipazhin.

10. “Lundrimi për zbavitje” është ai lloj lundrimi, i cili realizohet me mjetet lundruese për qëllime turistike dhe argëtim, të përcaktuara nga ky ligj dhe në përputhje me legjislacionin detar në fuqi, qëllimi specifik i të cilit është turizmi dhe argëtimi.

11. “Lundrim mbi dallgë (*Surf*)” është aktivitet që ushtrohet në ujërat sipërfaqësore, në të cilin ushtruesi hipën në anën e përparme ose në sipërfaqen e një dallge në lëvizje, që zakonisht e mbart/zhvendos drejt bregut.

12. “Mjete të tjera të vogla lundruese”, në kuptim të këtij ligji, janë mjetet e tjera ujore, që përdoren për qëllime turistike, kënaqësie dhe argëtimi.

13. “Mjet lundrues i arrestuar” ka të njëjtin kuptim sipas përcaktimeve Konventës të Kombeve të Bashkuara “Për arrestimin e anijeve, 1999”, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 10 035, datë 22.12.2008.

14. “Operator i turizmit detar” është ai subjekt, që ushtron aktivitete të turizmit detar, i cili është i certifikuar nga ministria përgjegjëse për turizmin, sipas parashikimeve të këtij ligji.

15. “Peshkimi turistik” ka të njëjtin kuptim sipas legjislacionit në fuqi për peshkimin.

16. “Pontil” ka të njëjtin kuptim sipas legjislacionit për portet turistike.

17. “Port turistik” ka të njëjtin kuptim sipas legjislacionit për portet turistike.

18. “Stacion sezonal ankorimi” është grup bovash, së bashku me infrastrukturën provizore, të përshtatshme për bregëzimin e mjeteve lundruese turistike apo të argëtimit.

19. “*Windsurf*” është aktiviteti i lëvizjes në ujë në një dërrasë me vela.

20. “*Wakeboard*” është aktiviteti i lëvizjes në ujë në një dërrasë lundruese të vogël dhe kryerjes së manovrave akrobatike, ndërsa ajo tërhiqet nga një varkë me motor.

21. “Ujëra të brendshme” përfshijnë edhe hapësirat ujore në territorin tokësor: lumenjtë, liqenet, rezervuarët, kënetat.

22. “Zhytje” është aktivitet për qëllime zbavitjeje dhe argëtimi, që ushtrohet nga individët, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

## KREU II

### AKTIVITETET E TURIZMIT DETAR

#### Neni 4

##### **Aktivitetet turistike detare**

1. Aktivitetet turistike detare, që kryhen nëpërmjet mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi në vijën bregdetare, hapësirën detare dhe në ujërat e brendshme në Republikën e Shqipërisë, janë:

- a) lundrimi për zbavitje;
- b) peshkimi turistik;
- c) peshkim nën ujë;
- ç) zhytje çlodhëse;
- d) aktivitete të tjera ujore, si *kitesurfing*, *windsurf*, ski në ujë, *wakeboard*, motor uji etj.

2. Rregulla më të hollësishme për zhvillimin e aktiviteteve të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, me përjashtim të shkronjës “b”, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për turizmin dhe të ministrit përgjegjës për transportet.

#### Neni 5

##### **Operatorët e turizmit detar**

*(Ndryshuar fjalë në pikën 1 dhe shfuqizuar pika 2 me ligjin nr. 105/2024, datë 19.9.2024)*

1. Aktivitetet e turizmit detar për qëllime çlodhëse dhe argëtuese, me përjashtim të peshkimit turistik, ofrohen vetëm nga operatorët e turizmit detar të certifikuar dhe që ofrojnë për klientët shërbime për ushtrimin e aktiviteteve të përcaktuara nga ky ligj.

2. Shfuqizuar.

3. Operatori i turizmit detar, para fillimit të aktiviteteve të turizmit detar, pajset me certifikatë për ushtrimin e këtyre veprimtarive nga ministria përgjegjëse për turizmin. Kriteret dhe procedura për certifikimin përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për turizmin.

4. Operatorët janë përgjegjës për përmbushjen e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj dhe mospërmbushja e tyre i ngarkon me përgjegjësi administrative, sipas nenit 24, të këtij ligji.

#### Neni 6

##### **Zonat për ushtrimin e aktiviteteve të turizmit detar**

1. Aktivitetet e turizmit detar ushtrohen vetëm në vende të lejuara, sipas zonave të publikuara nga ministria përgjegjëse për turizmin, dhe monitorohen nga strukturat përgjegjëse inspektuese.

2. Zonat për ushtrimin e aktiviteteve të turizmit detar përcaktohen nga ministria përgjegjëse për turizmin, në bashkëpunim me ministritë përgjegjëse për transportin, peshkimin, mbrojtjen dhe kulturën, bazuar në kriteret e sigurisë publike, lundrimore, gjeografike dhe kulturore, duke marrë në konsideratë shfrytëzimin e hapësirës detare edhe për qëllime të tjera, dhe miratohen nga Këshilli Kombëtar i Territorit.

#### Neni 7

## **Klientët e aktiviteteve të turizmit detar**

1. Klientët e aktiviteteve të turizmit detar janë shtetasit shqiptarë apo të huaj, që ushtrojnë këto aktivitete në vijën bregdetare, hapësirën detare dhe ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë, dhe ndahen në amatorë e profesionistë, me përjashtim të rasteve kur legjislacioni specifik parashikon ndryshe.

2. Kur klientët kërkojnë kryerjen e aktiviteteve të turizmit detar pranë një operatori të turizmit detar, ky operator ka detyrimin që, në varësi të klientit, t'i garantojë shërbimin me udhërrëfyes të licencuar për këto lloj aktivitete, sipas ligjit për turizmin.

3. Pavarësisht parashikimit të pikës 2, të këtij neni, për klientin amator operatori i turizmit detar ka detyrimin e garantimit të shërbimit me udhërrëfyes të licencuar.

## **KREU III**

### **KATEGORIZIMI I MJETEVE LUNDRUESE DHE PËRDORIMI I TYRE**

#### **Neni 8**

#### **Mjetet lundruese për qëllime turistike dhe argëtim**

1. Mjetet lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi janë në pronësi/përdorim të vetë individit ose në pronësi/përdorim të operatorëve të turizmit detar dhe ndahen në:

- a) kroçera;
- b) jahte;
- c) mjete të tjera të vogla lundruese.

2. Mjetet lundruese, të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, mund të përdoren për qëllime tregtare kur janë:

- a) në pronësi;
- b) objekt i kontratave të qirasë.

3. Në çdo rast, qëllimi i përdorimit të mjetit lundrues përcaktohet nga shoqëria klasifikuese, nëpërmjet certifikimit, në përputhje me legjislacion në fuqi.

4. Mjetet lundruese regjistrohen në regjistrin e mjeteve lundruese dhe detare pranë Drejtorisë së Përgjithshme Detare, në përputhje me parashikimet e Kodit Detar dhe legjislacionin në fuqi.

5. Mjetet lundruese, të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, kur regjistrohen për herë të parë dhe përdoren vetëm për qëllime tregtare duhet të plotësojnë këto kriteret:

- a) kallumi dhe motori të jenë më të reja se 20 vjet;
- b) certifikata e lundrimit të sigurt, nga shoqëria klasifikuese, të jetë e vlefshme;
- c) të ketë policën e sigurimit brenda periudhës së vlefshmërisë dhe që garanton jetën, shëndetin e klientëve dhe përgjegjësinë për dëmet që mund t'u shkaktohen të tretëve.

#### **Neni 9**

#### **Kroçera**

1. Kroçera me flamur shqiptar përdoret kur është e regjistruar në regjistrin detar shqiptar dhe është në pronësi/përdorim të operatorëve të turizmit detar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Kroçerat me flamur të huaj hyjnë në hapësirën detare dhe ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë në përputhje me parashikimet e Kodit Detar dhe legjislacionit në fuqi.

## Neni 10

### Jahti

1. Në varësi të regjimeve juridike të përshtatshme, jahtet ndahen në:
  - a) jaht për veprimtari tregtare, i cili është një mjet lundrues i destinuar për dhënie me qira, me ekuipazh ose pa të;
  - b) jaht për nevoja personale të individëve, vendas ose të huaj, i cili është në pronësi të tyre dhe nuk përdoret për veprimtari tregtare.
2. Operatorët e turizmit detar, të cilët përdorin jahte për veprimtari tregtare, licencohen në Shqipëri, në përputhje me kërkesat e këtij ligji.
3. Operatori i turizmit detar, në rastin kur jahtin e jep me qira apo në përdorim, në një nga format e kontratave të çartërimit “*Bareboat*” apo “Çarter me kohë”, ka detyrimin të njoftojë kapitenerinë e portit përkatës.

## Neni 11

### Mjete të tjera të vogla lundruese

- Mjete të tjera të vogla lundruese përfshijnë skafet dhe mjetet e mëposhtme:
- a) mjete për lundrim brenda 500 metrave nga bregdeti, si pedalonët, *surf*-et me vela, kanoat, kajakët dhe çdo mjet jovetëlëvizës;
  - b) mjete lundruese që vihen në lëvizje nga motorë me fuqi motorike më të vogël se 30 kW ose 40,8 HP, të cilat nuk kërkojnë certifikatë të lundrimit të sigurt;
  - c) mjete për lundrim deri në 1 milje detare nga bregu;
  - ç) mjete për lundrim deri në 3 milje detare nga bregu;
  - d) mjete për lundrim deri në 6 milje detare nga bregu;
  - dh) mjete për lundrim deri në 12 milje detare.

## Neni 12

### Kontratat për qëllime tregtare të mjeteve lundruese

*(Ndryshuar fjalë dhe togfjalësh në pikën 1 me ligjin nr. 105/2024, datë 19.9.2024)*

1. Kontratat që lidhen me qëllim realizimin e aktiviteteve turistike detare janë kontrata “*Bareboat*” dhe “Çarter me kohë”. Këto kontrata lidhen vetëm kur njëra nga palët është operator i turizmit detar i certifikuar në Republikën e Shqipërisë.
2. Kontrata “*Bareboat*” e mjetit lundrues përcakton të drejtat dhe detyrimet ndërmjet palëve, si dhe dorëzimin e mjetit te përfituesi, i cili merr përsipër përgjegjësitë dhe rreziqet gjatë lundrimit. Kjo kontratë hartohet me shkrim, nënshkruhet nga palët dhe në bord mbahet kopja origjinale ose një kopje e njësuar me origjinalin.
3. Kontrata “Çarter me kohë” e mjetit lundrues përcakton të drejtat dhe detyrimet ndërmjet palëve dhe parashikon që mjeti i dhënë në përdorim nuk dorëzohet, por mbetet në dispozicion të përdoruesit, së bashku me ekuipazhin. Kjo kontratë hartohet me shkrim dhe në bord mbahet kopja origjinale ose një kopje e njësuar me origjinalin.
4. Operatori i turizmit detar, që disponon mjetin lundrues dhe lidh njërën nga kontratat e mësipërme, njofton kapitenerinë e portit.
5. Një individ i huaj, që disponon një dëshmi për drejtimin e mjeteve lundruese të vogla, mund të drejtojë, përkohësisht, një mjet lundrues turistik shqiptar për qëllime turistike dhe argëtimi. Në këtë rast, operatori i turizmit detar njofton kapitenerinë e portit.

## KREU IV

### PËRDORIMI I HAPËSIRËS DETARE PËR AKTIVITETE TURISTIKE

#### Neni 13

##### **Hyrja në hapësirën detare dhe ujërat e brendshme shqiptare**

1. Hyrja në hapësirën detare dhe në ujërat e brendshme bëhet sipas procedurave kufitare, portuale dhe doganore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Lëvizja, qëndrimi dhe lundrimi në ujërat e brendshme i një mjeti të huaj lundruar, për qëllime turistike dhe argëtimi, lejohet për një periudhë jo më shumë se 18 muaj, pas marrjes së njoftimit nga kapiteneria.

3. Aplikimi dhe dokumentacioni dorëzohen para mbërritjes në hapësirën detare dhe ujërat e brendshme. Kërkesa elektronike duhet të përcaktojë parashikimin për datën e hyrjes dhe periudhën e qëndrimit në ujërat e brendshme.

4. Aplikimi për shërbimet e pikës 1 dhe 2, të këtij neni, bëhet nëpërmjet kapitenerisë së porteve, e cila i kryen këto shërbime *on-line*. Rregullat më të hollësishme për funksionimin e këtyre shërbimeve, institucionet e përfshira, procedura që ndiqet dhe dokumentacioni përkatës miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për transportet.

#### Neni 14

##### **Përgjashtimet për mjetet e lundrimit në ruajtje**

1. Mjeti i lundrimit mund të qëndrojë në ujërat e brendshme, të lundrueshme, shqiptare edhe përtej afatit 18-mujor nëse është arrestuar, bllokuar, sekuestruar, vendosur peng apo nëse ndaj tij është vendosur masë sigurimi padie, sipas legjislacionit të brendshëm në fuqi dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë.

2. Me vendosjen në ruajtje të mjetit lundruar, institucioni që ka vendosur arrestimin, bllokimin, sekuestrimin njofton, në çdo rast, edhe autoritetet doganore, në rrugë elektronike, duke i bashkëngjitur dokumentet e bordit dhe kërkesën për vendosjen e vulave sipas parashikimeve të legjislacionit doganor.

#### Neni 15

##### **Qëndrimi në hapësirën detare dhe ujërat e brendshme shqiptare**

1. Gjatë periudhës 18-mujore, të përcaktuara në nenin 13, të këtij ligji, mjetet lundruese, me flamur të huaj, mund të lëvizin lirshëm dhe të qëndrojnë brenda hapësirës detare dhe ujërave të brendshme shqiptare.

2. Mjetet lundruese, me flamur të huaj, largohen nga hapësira detare shqiptare, gjatë periudhës së përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, pasi kanë ndjekur procedurat e nevojshme të daljes.

#### Neni 16

##### **Lundrimi dhe siguria e jetës**

1. Kur kërkohet nga konventa ndërkombëtare për parandalimin e ndotjes nga anijet, konventa për mbrojtjen e jetës detare dhe të zonës bregdetare mesdhetare ose konventa të tjera ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, mjetet e lundrimit duhet të jenë të pajisura, përveç pajisjeve të sinjalizimit e shpëtimit, edhe me pajisjet e dizajnuara për të parandaluar ndotjen e detit nga vajrat, ujërat vajore dhe mbeturinat, me qëllim ruajtjen e detit nga substanca të tilla, që mund të zbrazen e hidhen në det.

2. Në rast të përplasjes në det midis mjeteve të lundrimit të përmendura në këtë ligj ose midis atyre dhe një mjeti shqiptar të lundrimit, zbatohet Rregullorja Ndërkombëtare për Parandalimin e Përplasjes në Det (COLREGS 1972).

3. Në rast fatkeqësie në det zbatohen parashikimet e Konventës Ndërkombëtare të Kërkimit Detar dhe Shpëtimit (SAR) dhe legjislacioni kombëtar në fuqi.

## KREU V

### NDALIMET DHE KUFIZIMET

#### Neni 17

#### **Ndalimet dhe kufizimet për peshkimin turistik**

1. Për ushtrimin e aktivitetit të peshkimin turistik zbatohen ndalimet dhe kufizimet e parashikuara në legjislacionin në fuqi për peshkimin.

2. Peshkimi turistik kryhet në përputhje me parashikimet në legjislacionin në fuqi për peshkimin dhe rregullat për ushtrimin e peshkimit turistik, mjetet që duhen të përdoren, lloji dhe sasia e gjallesave detare që peshkohen janë të përcaktuara në legjislacionin për peshkimin.

#### Neni 18

#### **Ndalime dhe kufizime për mjetet e lundrimit**

Klientëve, që përdorin mjete lundrimi për qëllime turistike dhe argëtimi, u ndalohet:

a) hedhja e mbeturinave në det dhe/ose derdhja e materialit ndotës nga mjetet e lundrimit për zbavitje, që lundrojnë ose qëndrojnë në ujërat territoriale shqiptare;

b) lëshimi ose hedhja në det e vajrave, ujërave me vaj, mbeturinave, si dhe çdo substancë tjetër që ndot mjedisin nga mjetet e lundrimit për zbavitje;

c) përvetësimi dhe tjetërsimi i paligjshëm i çdo pasurie dhe pasurive që i përkasin trashëgimisë arkeologjike nënujore, sipas konventës së Organizatës për Edukim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara (UNESCO-s) për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Nënujore të vitit 2001, është e ndaluar.

## KREU VI

### INFRASTRUKTURA PËR AKTIVITETET E TURIZMIT DETAR

#### Neni 19

#### **Ankorimi/bregëzimi mjeteve lundruese**

1. Mjetet e lundrimit, si rregull, kanë të drejtë të ankorohen/bregëzohen, sipas parashikimeve të këtij ligji, në të gjitha portet turistike, të cilat janë shpallur si të tilla, në përputhje me legjislacionin për portet turistike.

2. Mjetet e lundrimit ankorohen/bregëzohen edhe në porte të tjera, pas dhënies së lejes nga kapiteneria e portit.

3. Në këtë rast, ndërmjet operatorit apo individit, që përdor mjetin e lundrimit për qëllime turistike dhe argëtimi, dhe subjektit, që administron portin, lidhet një kontratë tip, e cila, ndër të tjera, duhet të përmbajë:

- a) identitetin e palëve;
- b) kushtet e bregëzimit;
- c) kohën e bregëzimit;
- ç) tarifën, që do të aplikohen;
- d) ruajtjen e mjetit gjatë bregëzimit;
- dh) mënyrën e dorëzimit të mbetjeve të mjetit;
- e) masat për sigurinë dhe ruajtjen e mjedisit.

Neni 20

### **Portet dhe pontilet turistike**

1. Në portin/pontilin turistik lejohen të gjitha veprimtaritë në funksion të turizmit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për portet turistike.

2. Për ushtrimin e aktivitetit të turizmit detar, në portet turistike funksionon administrata e portit turistik, e cila bashkërendon punën me strukturën përgjegjëse për inspektimin në turizëm, për ushtrimin e veprimtarive brenda kërkesave të këtij ligji dhe ligjit në fuqi për portet turistike.

3. Mjetet e lundrimit detar për zbavitje lejohen të bregëzohen në portet turistike dhe pontile, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi për portet turistike.

Neni 21

### **Stacionet sezonale të ankorimit/bregëzimit**

1. Gjatë gjithë bregdetit vendosen stacione sezonale të bregëzimit të mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi.

2. Kriteret e vendosjes dhe të funksionimit të tyre miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për transportin dhe ministrit përgjegjës për turizmin.

Neni 22

### **Mbikëqyrja e vendeve të ankorimit/bregëzimit të mjeteve lundruese**

1. Mjetet lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi dhe vendet ku ato ankorohen/bregëzohen u nënshtrohen mbikëqyrjeve të vazhdueshme nga ana e autoriteteve kompetente, me qëllim shmangien e:

- a) shkeljeve të legjislacionit doganor dhe të regjimit kufitar;
- b) kryerjeve të veprave penale;
- c) ndotjes mjedisore;
- ç) respektimit të standardeve në fushën e turizmit.

2. Secili prej autoriteteve kompetente ka të drejtë që të ndërhyjë, në përputhje me legjislacionin që rregullon fushën e tij të veprimtimit.

KREU VII



## INSPEKTIMI DHE KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 23

### **Inspektimi**

1. Inspektimi i aktiviteteve të turizmit detar, operatorit të turizmit detar dhe i mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin nga strukturat përgjegjëse inspektuese, sipas fushave të veprimtarisë përkatëse.

2. Inspektimi në lidhje me autorizimet dhe deklaratimet për ushtrimin e peshkimit turistik kontrollon nga struktura përgjegjëse për peshkimin.

Neni 24

### **Kundërvajtjet administrative**

*(Hequr fjalë në shkronjën "ç" të pikës 1 dhe në pikën 3 me ligjin nr. 105/2024, datë 19.9.2024)*

1. Përveç kundërvajtjeve administrative, të parashikuara në Kodin Detar, për të cilat zbatohen procedurat dhe sanksionet përkatëse, shkeljet e mëposhtme janë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, përkatësisht:

a) mosnjohimi i lidhjes së kontratave për mjetet lundruese, sipas nenit 12, të këtij ligji, dënohet me gjobë, nga 10 000 (dhjetë mijë) deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

b) qëndrimi dhe/ose lundrimi në ujërat e brendshme përtej afatit 18-mujor, sipas nenit 13, të këtij ligji, dënohet me gjobë, nga 100 000 (njëqind mijë) deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë;

c) ushtrimi i aktiviteteve detare jashtë zonave dhe vendeve të miratuara, sipas nenit 6, të këtij ligji, dënohet me gjobë, nga 100 000 (njëqind mijë) deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë;

ç) ushtrimi i veprimtarisë së operatorit detar të turizmit pa certifikatën përkatëse, sipas nenit 5, të këtij ligji, dënohet me gjobë, nga 100 000 (njëqind mijë) deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë.

2. Procedurat e konstatimit, të vendosjes, ankimit dhe ekzekutimit të gjobave bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative dhe inspektimet.

3. Subjektet e gjobitura paguajnë gjobën brenda 10 ditëve, nga data kur vendimi i dënimit me gjobë është bërë titull ekzekutiv. Në rast përsëritje të shkeljeve të mësipërme, subjektet i nënshtrohen procedurave ligjore deri në shfuqizimin e certifikatës përkatëse.

Neni 25

### **Ankimi**

*(Shfuqizuar pika 2 dhe ndryshuar togjalësh në pikën 3 me ligjin nr. 105/2024, datë 19.9.2024)*

1. Ankimi administrativ, në lidhje me gjobat, bëhet në përputhje me përcaktimet në dispozitat e legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

2. Shfuqizuar.

3. Pas përfundimit të procedurave të ankimit administrativ, sipas pikës 1, të këtij neni, bëhet ankim në gjykatën administrative, brenda afateve dhe sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

KREU VIII

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 26

### **Aktet nënligjore**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 4, pika 2; 13, pika 4; dhe 21, pika 2, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për turizmin për nxjerrjen e aktit nënligjor në zbatim të nenit 5, pika 3, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 27

### **Shfuqizimet**

Çdo dispozitë e akteve ligjore, që bie ndesh me parashikimet e këtij ligji, shfuqizohet dhe institucionet përgjegjëse ngarkohen për rishikimin e kuadrit ligjor në fuqi.

Neni 28

### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**K R Y E T A R I**

**Gramoz RUÇI**

Miraturar në datën 23.4.2020